



**METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFAVE TË OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)**


DT-KO-005

ver. 2.0

faqe 1 nga 12


**METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)**

**Prill 2017,
Prishtinë**

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 2 nga 12</i>

PËRMBAJTJA

1.0	HYRJE	3
1.1	Qëllimi	3
1.2	Fushëveprimi	3
1.3	Kërkesat ligjore dhe rregullative	3
1.4	Llojet e Tarifave dhe Taksave të OST/OT-së	4
2.0	ARANZHIMET KONTRAKTUESE.....	4
3.0	BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	5
3.1	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.....	5
3.2	Shërbimet e Transmetimit	6
4.0	TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)	6
4.1	Parimet e përgjithshme për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale.....	6
4.2	Alokimi i MAR për aktivitete.....	7
4.3	Ndarja e të hyrave të lejuara ndërmjet 400/220kV dhe 110kV	7
5.0	STRUKTURA E TARIFAVE SHST	8
5.1	Tiparet kryesore	8
5.2	Baza për përcaktimin e tarifave.....	8
5.3	Formulat për llogaritjen e Tarifave SHST	8
5.4	Llojet e Tarifave SHST.....	9
6.0	PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR	10
	SHTOJCA 1: ALOKIMI I KOSTOVE	11
	SHTOJCA 2: METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË DETYRIMEVE SHST	12

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 3 nga 12</i>

1.0 HYRJE

1.1 Qëllimi

Ky dokument përmban metodologjinë e cila do të përdoret nga KOSTT gjatë përcaktimit të tarifave që Shfrytëzuesit e Sistemit i paguajnë për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit¹, (Tarifat SHST)

Taksat për kyçje në sistemin e transmetimit janë të rregulluara me Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, e cila është nxjerrë ndaras nga KOSTT dhe është miratuar nga ZRrE².

1.2 Fushëveprimi

Ky dokument mbulon:

1. Kornizën ligjore dhe rregullative për tarifave e shfrytëzimit të sistemit të transmetimit;
2. Përkufizimin e shërbimeve të Shfrytëzimit të Sistemit të Transmetimit (SHST);
3. Alokimin e kostove për SHST;
4. Kalkulimin e tarifave SHST

1.3 Kërkesat ligjore dhe rregullative

Kjo Metodologji merr parasysh dhe u përmbahet kërkesave të parashtruara në:


- Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081
- Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;

Kjo Metodologji gjithashtu është përgatitur në pajtim me dokumentet vijuese:

- Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
- Licencën e Operatorit të Tregut;

¹ Shfrytëzuesit e Sistemit janë përcaktuar me Ligjin për Energjinë Elektrike

² ZRrE është Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 4 nga 12</i>

- Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për të hyrat e OST/OT-së) ;
- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Taksave të Kyçjes.


1.4 Llojet e Tarifave dhe Taksave të OST/OT-së

- **Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST)** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me këtë dokument.
- **Tarifat e Operatorit të Sistemit** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit.
- **Tarifat e Operatorit të Tregut** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut.
- **Taksat e Kyçjes** - Mënyra e përcaktimit të këtyre taksave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Taksave të Kyçjes në Sistemin e Transmetimit.

2.0 ARANZHIMET KONTRAKTUESE

Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji përcakton kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji për konsumatorët si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve të tyre. Në të përshkruhen edhe parimet e përgjithshme të kyçjes dhe shfrytëzimit të sistemit të transmetimit, leximit, matjeve, faturimit dhe inkasimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

Sipas Rregullave të Tregut pagesa e detyrimeve ndaj KOSTT është e obliguar. Rregullat e Tregut përcaktojnë procedurat që duhet ndjekur në rast të kontesteve lidhur me detyrimet apo mos pagesën e tyre.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 5 nga 12</i>

3.0 BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Rregulla për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut përbën bazën për caktimin e Të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) në çdo vit përkatës, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Taksave të Kyçjes.

Sipas nenit 3 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), OST/OT do të propozojë tarifatat për shfrytëzim të rrjetit të transmetimit (SHST), tarifatat e operatorit të sistemit (OS), dhe tarifatat e operatorit të tregut (OT), ashtu që brenda çdo viti relevant, të hyrat që priten të mbledhë nga këto tarifa do të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga rregullatori.

Sipas nenit 17 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), OST/OT duhet të propozojë tarifatat SHST, në mënyrë që OST/OT t'i kthejnë të hyrat e tyre të lejuara të cilat nuk mbulohen me tarifa tjera.

Sipas nenit 18 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), Metodologjia e Tarifave SHST duhet të miratohet nga Rregullatori; Këtë metodologji dhe të gjitha amendamentet e mëvonshme të saj, OST/OT duhet ti dërgojë për aprovim tek Rregullatori së paku 15 ditë pune³ para datës së propozuar të hyrjes në fuqi të tyre.


3.1 Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

Licenca e OST-së kërkon nga KOSTT që gjatë vendosjes së çmimeve që do t'u ngarkohen shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit, i licencuari nuk duhet të ketë preferencë për ndonjë përdorues apo kategori të përdoruesve, nuk duhet që në mënyrë të paarsyeshme të ushtroj diskriminim ndaj ndonjë përdoruesi apo kategorie të përdoruesve dhe nuk duhet të vendos kushte dhe afate të padrejta dhe të vështira për kyçje në sistem apo përdorim të tij

Gjithashtu, kjo licencë kërkon që në procesin për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe taksave për kyçje, i licencuari do të siguroj sinjale të duhura për çmime jo diskriminuese ashtu që të inkurajojnë palët e reja për kyçje në rrjetin e transmetimit dhe qasjen në tregun e energjisë elektrike.

Licenca e OST-së kërkon nga KOSTT që të përgatisë dhe publikojë Planin Zhvillimor Investiv afatmesëm 5 vjeçar i cili rrjedh nga Plani Zhvillimor afatgjatë 10 vjeçar i Sistemit të Transmetimit.

³ Ditë pune janë të gjitha ditët e javës që me ligjet e Republikës së Kosovës konsiderohet të jenë ditë pune.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 6 nga 12</i>

3.2 Shërbimet e Transmetimit

Shërbimet e transmetimit përcaktohen në Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në Ligjin për Energjinë Elektrike, dhe përfshijnë si në vijim:

- Duhet të planifikoj, operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e transmetimit në përputhje me Kodet teknike, rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
- Është përgjegjës për funksionimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të Transmetimit, duke përfshirë rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Duhet të ofroj kushtet për kyçje në rrjetin transmetues dhe përdorim të sistemit të transmetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Për çdo kontest që mund të paraqitet nga kyçja në rrjetin transmetues apo përdorimi i Sistemit të Transmetimit, do të zbatohen dispozitat e Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.


4.0 TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)

4.1 Parimet e përgjithshme për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale

Të hyrat që KOSTT mund t'i mbledh përmes tarifave në një vit përcaktohen nga ZRrE përmes proceseve të shqyrtimit të MAR-it. Këto procese përbëhen nga shqyrtimi periodik dhe përshtatjet e rregullta për qëllim të indeksimit të kostove dhe të ardhurave të lejuara dhe përshtatjeve në rast të tejkalimit apo mosarritjes së mbulimit të kostove (shih nenin 3 të Rregullës për të hyrat e OST/OT-së).

Duke ndjekur këto procese, ZRrE përcakton MAR-in për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), pastaj i alokon këto kosto në secilin aktivitet ndaras për qëllim të përcaktimit të tarifave. Veç kësaj, OST/OT-së i lejohet të pranojë të hyra tjera të parregulluara të cilat përjashtohen gjatë llogaritjes së MAR-it. Këto të Hyra Tjera janë nga burimet në vijim:

- **Grantet:** ZRrE nuk merr parasysh të hyrat nga grantet në përlllogaritjen zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar. Asetet e financuara nga grantet nuk janë të përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara;
- **Të Hyrat nga kyçjet:** Asetet e kyçjes të financuara nga konsumatori nuk janë të përfshira në zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar, respektivisht nuk përfshihen në MAR-in e OST/OT-së. Trajtimi i

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 7 nga 12</i>

të hyrave nga ky aktivitet është i dhënë në Metodologjinë e Taksave për Kycje në Rrjetin e Transmetimit;

- **Të Hyrat/Shpenzimet nga transiti:** Të hyrat neto, përkatësisht diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga transiti përfshihet në llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale;
- **Të Hyrat nga Alokimi i Kapaciteteve Ndërkufitare:** Të hyrat nga alokimi i kapaciteteve kurdo që ka aktivitetet të tilla do të trajtohen gjatë përcaktimit të hyrave të lejuara maksimale;
- **Të Hyrat nga Shfrytëzimi i Kapaciteteve të Fijeve Optike:** KOSTT në të ardhmen pritet që të ketë të hyra nga dhënia me qira e infrastrukturës së fijeve optike;


4.2 Alokimi i MAR për aktivitetet

Faza e parë e përlllogaritjes së tarifave për përdoruesit është që të alokohet MAR i përcaktuar në shqyrtimin periodik/përshtatjet e rregullta tek aktivitetet e veçanta të SHST, Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut. Shtojca 1 përshkruan procesin e alokimit të kostove të SHST në hollësi.

4.3 Ndarja e të hyrave të lejuara ndërmjet 400/220kV dhe 110kV

Për qëllime të përlllogaritjes së tarifave të Shfrytëzimit të Sistemit të Transmetimit (SHST), të hyrat do të ndahen ndërmjet tarifave për përdorim të pjesës 400/220kV të sistemit të transmetimit dhe tarifave për përdorimin e pjesës 110 kV të sistemit. Përdoruesit e lidhur në 110 kV paguajnë edhe për përdorimin e pjesës 110 kV të sistemit dhe përdorimin e pjesës 400/220kV të sistemit; përdoruesit e lidhur në pjesën 400/220kV të sistemit paguajnë vetëm tarifën për përdorimin e sistemit 400/220kV.

Për të reflektuar detyrimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë Elektrike, që tarifën duhet të jenë jo diskriminuese dhe të ofrojnë sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit, KOSTT ka përcaktuar që qasja që reflekton kostot do ta bëjë alokimin e të ardhurave ndërmjet përdoruesve 400/220kV dhe 110kV bazuar në vlerat e aseteve të secilit nivel të tensionit.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 8 nga 12</i>

5.0 STRUKTURA E TARIFAVE SHST

5.1 Tiparet kryesore

Tiparet kryesore të strukturës së tarifave të transmetimit janë të përcaktuara në Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit Transmetimit (neni 7).

- *KOSTT do duhet të realizojë të hyrat nga Tarifat SHST, duke i alokuar ato 0% tek Gjenerimi dhe 100% tek Ngarkesa.*
- *Tarifat duhet të përcaktohen në atë mënyrë e cila mundëson diferencimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit.*

Siç u theksua më sipër, KOSTT propozon që tarifat SHST të jenë të ndryshme për shfrytëzuesit e kyçur në sistemin 110kV dhe për shfrytëzuesit e kyçur drejtpërdrejt në sistemin 400/220 kV.

5.2 Baza për përcaktimin e tarifave


Për të përcaktuar tarifat SHST të aplikueshme për shfrytëzues individualë, duhet të përcaktohet baza e tarifave. KOSTT konsideron se njësitë vijuese janë në pajtim me Parimet e Përcaktimit të Tarifave të Transmetimit:

- OST/OT do të kalkulojë tarifat SHST për çdo vit, para fillimit të vitit relevant tarifor, në pajtim me nenet 17 dhe 18 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT.
- Pas miratimit të tarifave nga ZRrE, KOSTT do t'i publikojë tarifat SHST.
- Tarifat do të kalkuloohen duke u bazuar në ngarkesën maksimale të pritur të sistemit të transmetimit.
- Kostot për të cilat tarifat kalkuloohen nuk ndërlidhen me lokacionin në sistemin e transmetimit.
- Tarifat do të paguhen për kW dhe do të aplikohen në ngarkesën e furnizuesit në orën e ngarkesës maksimale të sistemit në muajin përkatës të matur mujor dhe e korigjuar me koeficientin kundrejt pjesëmarrjes në ngarkesën maksimale vjetore të sistemit.

5.3 Formulatat për llogaritjen e Tarifave SHST

Formula e Alokimit të Të Hyrave SHST në Të Hyrat për SHST 400/220 kV dhe Të Hyrat SHST 110 kV:

$$B = A * \text{Faktori Alokues në bazë të Aseteve 400/220 kV}$$

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 9 nga 12</i>

$$C = A * \text{Faktori Alokues në bazë të Aseteve 100 kV}$$

Formulat e Llogaritjes së Tarifave SHST:

$$T\text{-SHST } 400/220 \text{ kV} = B / (D + E)$$

$$T\text{-SHST } 110 \text{ kV} = (C / E) + T\text{-SHST } 400/220 \text{ kV}$$

Përshkrimi dhe njësia:

A - Të Hyrat SHST - €

B - Të Hyrat SHST 400/220 kV - €

C - Të Hyrat SHST 110 kV - €

D - Ngarkesa e pritur në rrjetin 400/220 kV – **Piku 400/220 kV - MW**

E - Ngarkesa e pritur në rrjetin 110 kV – **Piku 110 kV - MW**


T- SHST 400/220 kV –Tarifa SHST për 400/220 kV - €/kW

T- SHST 110 kV – Tarifa SHST për 110 kV - €/kW

5.4 Llojet e Tarifave SHST

Tabela në vijim paraqet njësitë e përdorura për caktimin e tarifave, të cilave u bëhet referencë në Rregullat e Tregut (sipas emrit dhe variablave) dhe njësitë matëse në këtë dokument me të cilat ato ndërlidhen.

Lloji i tarifës në Metodologjinë e Tarifave SHST dhe Njësitë	Variabla në Rregullat e Tregut	Emri i tarifës në Rregullat e Tregut
Tarifa SHST 400/220 kV për Furnizues - € / kW	TFRr 400/220	Tarifa e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit për nivel të Tensionit 400/220 kV
Tarifa SHST 110 kV për Furnizues - € / kW	TFRr 110	Tarifa e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit për nivel të Tensionit 110 kV


	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 10 nga 12</i>


6.0 PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR

Kjo metodologji e tarifave nuk merr parasysh në mënyrë eksplicite çfarëdo tejkalimi/mosarritje të MAR (apo elementeve të MAR të cilat i atribuohen aktiviteteve të OST/OT) në vitin relevant. Mekanizmi për përshtatjen e nën mbulimit apo mbi mbulimit të MAR është i përfshirë në kalkulimin e të hyrave të lejuara maksimale për vitin relevant tarifor, në bazë të përcaktimit në Rregullën për të Hyrat e OST/OT-së

SHTOJCA 1: ALOKIMI I KOSTOVE

Në figurën e mëposhtme është paraqitur parimi i alokimit të kostove sipas aktiviteteve: Shfrytëzimi i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit dhe Operatori i Tregut.



	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (SHST)	DT-KO-005
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 12 nga 12</i>

SHTOJCA 2: METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË DETYRIMEVE SHST

Shtojca 2 është përgatitur në funksion të bazës së llogaritjes së detyrimeve të shfrytëzuesve të sistemit ndaj OST/OT-së, deri në aprovimin e Rregullave të Tregut.

$$PF_n = NF_{nh} * \frac{NMS}{\sum_1^n NF_n} * T_{SHST} / 12$$

Ku :

PF_n - pagesa e furnizuesit n

NF_{nh} - Ngarkesa e furnizuesit në orën e ngarkesës maksimale mujore të sistemit

NMS - Ngarkesa maksimale vjetore e sistemit

$\sum_1^n NF_n$ - Shuma e ngarkesës së furnizuesve në orën e ngarkesës maksimale mujore të sistemit

h - ora kur ka ndodhur ngarkesa maksimale gjatë një muaji.

Pjesëtohet për 12 për qëllim të llogaritjes së detyrimeve mujore.

-fundi i dokumentit -